



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 649/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “A&T” sh.a në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-71840-05-29-2018, me objekt: “Blerje Karburanti për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 6.000.000,00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 12.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a Sarandë.”

Ankimues:

“A&T” sh.a
Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Toëer, Kati 7/3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime sh.a Sarandë
Gjashtë-Sarandë

Subjekte tw Interesuara:

“Islamaj” sh.p.k
Vlore Sarande, Gjashte

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.05.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-71840-05-29-2018, me objekt: “Blerje Karburanti për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 6.000.000,00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 12.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë.

II.2. Në datën 19.06.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------------------------|
| 1. “A&T” sh.a | 140.05 lekë, skualifikuar |
| 2. “Islamaj” sh.p.k | 142.76 lekë, kualifikuar |
| 3. “Das Oil” sh.p.k | 143.35 lekë, skualifikuar |
| 4. “Kastrati” sh.p.k | 146.82 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “A&T” sh.a rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentin:

“Nuk ka paraqitur dokumentin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjitha pikat që administrojnë sipas QKB. Mosparaqitja e këtij dokumenti nuk plotëson pikën 1.d të kriterëve të vecanta sipas DST.”

II.3. Në datën 22.06.2018 operatori ekonomik “A&T” sh.a ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit

II.4. Në datën 28.06.2018 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, duke e njoftuar elektronikisht operatorin ekonomik ankimues për skualifikimin e tij si më poshtë:

- 1. Nuk ka paraqitur dokumentin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjitha pikat që administrojnë sipas QKB. Mos paraqitja e këtij dokumenti nuk plotëson pikën 1.d të Kriterëve Te Vecanta sipas DST.*
- 2. Lidhur me inspektimin e dokumentacionit të Operatorit Ekonomik A&T shpk dhe 2A2F-L OIL:*

Operatori Ekonomik ka paraqitur këto dokumenta të cilat u shqyrtuan:

Nga inspektimi i dokumentacionit të lartepërmendur rezulton se:

- 1) Kontrata e bashkëpunimit midis Shoqërisë A&T shpk dhe shoqërisë 2A2F-L shpk është e nënshkruar nga z. Fabian Goci në të dy palet.*

Konkluzion: Kjo kontratë është e lidhur midis dy operatoreve (shoqëri) të tregëtimit me karburant. Rrjedhimisht duke u mbështetur në DST pika 2.3.2 pika.d) : “Vertetim nga njësitë administrative vendore për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore, për vitin 2017, për shoqërinë e dytë”, duhet domosdoshmërisht që Operatori ofertues A&T shpk të paraqiste vertetimet për detyrimeve të taksave vendore, për operatorin me të cilin ka lidhur kontratë bashkëpunimi 2A2F-L OIL, sipas QKB-së të kësaj shoqëri për vendodhjet e më poshteme të shoqërisë 2A2F-L OIL:

- Gjirrokaster Gjirrokaster GJIROKASTER distributor karburanti dhe Gazi, zona kadastrale Nr. 1369, me Nr. Pasurie 144/29, Cepune

- Tirane Tirane TIRANE Lagjja Ali demi, Rruga Shemsi Haka, zona Kadastrale Nr. 8180, Nr. Pasurie 5/240

- Tirane Vore Mucaj Rruga Nacionale Fushe Kruje – Vore km 1, zona kadastrale 2726, me Nr. Pasurie 22/19

Operatori ka paraqitur dokument për shoqërinë e dytë me të cilin ka lidhur kontratë bashkëpunimi 2A2F-L OIL, vetëm një vertetim të një prej pikave që ky operator operon në teritorin e Bashkisë Sarandë.

Per këto arsye bazuar në ligjin 9855, datë 26.12.2007 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” i ndryshuar, Neni 53, pika 3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Operatori Ekonomik nuk ka dorezuar dokumentat e plota per te gene oferte e kualifikueshme.

3. Lidhur me inspektimin e dokumentacionit te Operatorit Ekonomik A&T shpk.

Autorizimi i pikes se sherbimit Brenda teritorit te bashkise Sarande.

Ky autorizim i cili leshohet nga Bashkia Sarande, eshte detyrim qe duhet te permbushet nga firma 2A2F-L qe e ka si pike sherbimi. Por rezulton se ky autorizim eshte ne emer te shoqerise A.K.P Petroleum shpk me administrator Z.Fiqiri Hoxha per nje periudhe 5 vjecare. Shoqeria A.K.P Petroleum shpk me administrator Z.Fiqiri Hoxha, sipas QKB-se te paraqitur nga shoqeria A&T shpk, rezulton se ka ndryshuar emrin dhe administratorin me date 24.12.2014, nga shoqeria A.K.P Petroleum shpk me administrator Z.Fiqiri Hoxha ne emrin dhe e shoqeris A&T shpk me administrator Z.Fabian Goci.

Konkluzioni : Ky autorizim i perket ofertuesit shoqerise A&T shpk, e cila sipas QKB nuk ka pike ku ushtron aktivitetin ne teritorin e bashkise Sarande. Si rezultat shoqeria me te cilen A&T shpk ka lidhe kontrat bashkëpunimi ne teritorin e bashkise Sarande “2A2F-L OIL” e cila tregeton nafte me pakicë, operon ne territorin e bashkise Sarande pa Autorizim.

II.5. Në datën 02.07.2018 operatori ekonomik “A&T” sh.a ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendohet se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje zyrtare ankesës së bërë pranë këtij të fundit, por elektronikisht është njoftuar edhe për disa asye shtesë, në tejkalim të kompetencave të KSHA-së, arsye të cilat kundërshtohen nga ankimuesi.

II.6. Në datën 26.07.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1207/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 538 prot., datë 23.07.2018, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka vendosur mospranimin e ankesës së ankimuesit me të njëjtat argumenta të bëra më dijë këtij të fundit nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve në rivlerësimin e datës 28.06.2018 si dhe nëpërmjet shkresës nr.477 prot., datë 29.06.2018 drejtuar operatorit ekonomik “A&T” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen skualifikimit të operatorit ekonomik “A&T” sh.a se: “Nuk ka paraqitur dokumentin e shlyerjes se detyrimeve te matuaruara te energjise elektrike per te gjitha pikat qe

administron sipas QKB. Mos paraqitja e ketij dokumenti nuk ploteson pikën 1.d të Kriterëve të Vecanta sipas DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “d” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

- Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike operatori ekonomik “A&T” sh.a në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Vërtetim Debie Nr.4498 Prot datë 29.05.2018 lëshuar nga OSHEE me anë të së cilës vërtetohet se: Kërkuesi “A&T” sh.a nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën/kontratën (me kod) [...] rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 28.05.2018 duke përfshirë faturën koherente të muajit prill 2018.

III.1.3. Në Nenin 27, pika 5, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: [...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasti kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

III.1.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

III.1.5.Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë: 7 “[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkuar të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).

2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.

3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimt bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.

2. Konsumatori rezulton debitor.

3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.

4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.

5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimit në gjykatë. [...]

Gjithashtu referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 30.03.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 6287/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, në të cilin dorëzohet një kopje e formatit standard të lëshimit të vërtetimit të debisë nga ku rezulton se është si më poshtë vijon: “[...] Bazuar në deklarinë e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. _____ vërtetojmë se kërkuesi _____ nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratat (me kod) _____, titular i së cilës/cilavë është _____ rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e përlllogaritur deri në datën _____._____ pa përfshirë faturën koherente të muajit _____ [....]

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes “A&T” sh.a ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim, sipas formatit të miratuar, me anë

të së cilës vërtetohet se subjekti “A&T” sh.a nuk rezulton debitor, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”. KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Sh.a është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, OSHEE sh.a. ndër të tjera sqaron se “Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur: 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit. 2. Konsumatori rezulton debitor. 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste. 4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “A&T” sh.a në këtë procedurë prokurimi, plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për konfirmimin nga ana e OSHEE-së mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik “A&T” sh.a, që është i regjistruar në Shqipëri.

Pretendimi i ankimesit qëndron.

III.2. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimesit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se, në datën 19.06.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomikë ankimesit, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku konstatohet se operatori ekonomik “A&T” sh.p.k është skualifikuar me argumentin si më poshtë vijon:

“Nuk ka paraqitur dokumentin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjitha pikat që administrojnë sipas QKB. Mosparaqitja e këtij dokumenti nuk plotëson pikën 1.d të kriterëve të vecanta sipas DST.”

III.2.1. Në datën 22.06.2018 operatori ekonomik “A&T” sh.a ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit

III.2.2. Në përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik “A&T” sh.p.k si dhe nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se në datën 28.06.2018 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit dhe ka njoftuar ankimesin, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), për skualifikimin e ofertës së tij, me argumentat si

më poshtë vijon:

1. *Nuk ka paraqitur dokumentin e shlyerjes se detyrimeve te matuaruara te energjise elektrike per te gjitha pikat qe administron sipas QKB. Mos paraqitja e ketij dokumenti nuk ploteson piken 1.d te Kriteve Te Vecanta sipas DST.*
2. *Lidhur me inspektimin e dokumentacionit te Operatorit Ekonomik A&T shpk dhe 2A2F-L OIL:*

Operatori Ekonomik ka paraqitur keto dokumenta te cilat u shqyrtuan:

Nga inspektimi i dokumentacionit te lartepmendur rezulton se:

Kontrata e bashkepunimit midis Shoqerise A&T shpk dhe shoqerise 2A2F-L shpk eshte e nenshkruar nga z. Fabian Goci ne te dy palet.

Konkluzion: Kjo kontrate eshte e lidhur midis dy operatoreve (shoqeri) te tregetimit me karburant. Rrjedhimisht duke u mbeshtetur ne DST pika 2.3.2 pika.d) : “Vertetim nga njesite administrative vendore per shlyerjen e detyrimeve te taksave vendore, per vitin 2017, per shoqerine e dyte”, duhej domosdoshmerisht qe Operatori ofertues A&T shpk te paraqiste vertetimet per detyrimeve te taksave vendore, per operatorin me te cilin ka lidhur kontrat bashkepunimi 2A2F-L OIL, sipas QKB-s te kesaj shoqeri per vendodhjet e me poshteme te shoqeris 2A2F-L OIL:

- Gjirokaster Gjirokaster GJIROKASTER distributor karburanti dhe Gazi, zona kadastrale Nr. 1369, me Nr. Pasurie 144/29, Cepune

- Tirane Tirane TIRANE Lagjja Ali demi, Rruga Shemsi Haka, zona Kadastrale Nr. 8180, Nr. Pasurie 5/240

- Tirane Vore Mucaj Rruga Nacionale Fushe Kruje– Vore km 1, zona kadastrale 2726, me Nr. Pasurie 22/19

Operatori ka paraqite dokument per shoqerine e dyte me te cilen ka lidhe kontrat bashkepunim 2A2F-L OIL, vetem nje vrtetim te nje prej pikave qe ky operator operon ne teritorin e Bashkis Sarande.

Per keto arsye bazuar ne ligjin 9855, datë 26.12.2007 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” i ndryshuar, Neni 53, pika 3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Operatori Ekonomik nuk ka dorezuar dokumentat e plota per te gene oferte e kualifikueshme.

3. *Lidhur me inspektimin e dokumentacionit te Operatorit Ekonomik A&T shpk.*

Autorizimi i pikes se sherbimit Brenda teritorit te bashkise Sarande.

Ky autorizim i cili leshohet nga Bashkia Sarande, eshte detyrim qe duhet te permbushet nga firma 2A2F-L qe e ka si pike sherbimi. Por rezulton se ky autorizim eshte ne emer te shoqerise A.K.P Petroleum shpk me administrator Z.Fiqiri Hoxha per nje periudhe 5 vjecare. Shoqeria A.K.P Petroleum shpk me administrator Z.Fiqiri Hoxha, sipas QKB-se te paraqitur nga shoqeria A&T shpk, rezulton se ka ndryshuar emrin dhe administratorin me date 24.12.2014, nga shoqeria A.K.P Petroleum shpk me administrator Z.Fiqiri Hoxha ne emrin dhe e shoqeris A&T shpk me administrator Z.Fabian Goci.

Konkluzioni : Ky autorizim i perket ofertuesit shoqerise A&T shpk, e cila sipas QKB nuk ka pike ku ushtron aktivitetin ne teritorin e bashkise Sarande. Si rezultat shoqeria me te cilen A&T shpk ka lidhe kontrat bashkëpunimi ne teritorin e bashkise Sarande “2A2F-L OIL” e cila tregeton nafte me pakicë, operon ne teritorin e bashkise Sarande pa Autorizim.

III.2.3. Pra KPP konstaton se KSHA, me iniciativën e saj, ka shtuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues, të cilat nuk i janë komunikuar ankimuesit në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO.

III.2.4. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”*. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”* Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”*. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”*. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.2.5. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së*

personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së operatorit ekonomik “A&T” shpk ka vendosur mospranimin e saj si dhe ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit, dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni 78 i VKM nr.914 datë 29.12.2014, nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A&T” sh.a për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-71840-05-29-2018, me objekt: “Blerje Karburanti për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 6.000.000,00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 12.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “A&T” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&T” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1207 Protokoli,
Datë 02.07.2018



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha